



DIXHITALIZIMI DHE E-SHËRBIMET NË MAQEDONINË E VERIUT: ANALIZË FUNKSIONALE

Botues:
Asociacioni për Iniciativa Demokratike



CENTER FOR SOCIAL INNOVATIONS

Autor i analizës:
Development Solutions (DeSo)



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen financiare të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Asociacionit për Iniciativa Demokratike Gostivar dhe Qendrës për Inovacione Sociale Blink 42-21 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I.....	4
HYRJE.....	4
METODOLOGJIA.....	5
1. DIXHITALIZIMI I E-SHËRBIMEVE – KONCEPTET BAZË	5
1.1. INFORMIMI.....	7
1.2. NDËRVEPRIM NJËKAHËSH.....	8
1.3. NDËRVEPRIM DYKAHËSH.....	8
1.4. TRANSAKSIONI.....	8
1.5. PERSONALIZIMI	8
1.6. PËRPARËSITË E APROVIMIT TË E-SHËRBIMEVE	9
1.7. SFIDAT PËR APROVIMIN E E-SHËRBIMEVE.....	9
1.7.1. HENDEKU DIXHITAL	10
1.7.2. BUOKRACIA DHE MENTALITETI I PËRDORUESVE.....	10
2. DIXHITALIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKENË REPUBLIKËNEMAQEDONISËSË VERIUT.....	11
3. PASQYRË E E-SHËRBIMEVE TË DISPONUESHME NË SEKTORË TË VEÇANTË.....	14
3.1. JURISPRUDENCA.....	14
3.2. POLICIA	15
3.3. VETËQEVERISJA LOKALE	18
3.4. SHËNDETI PUBLIK.....	18
3.5. ARSIMI.....	20
3.6. EKONOMIA	21
4. KONKLuzion	22
KAPITULLI II.....	23
RASTSTUDIMOR – INOVACIONI DIGJITAL INSTITUCIONAL.....	23
HYRJA.....	23
1. PRAKTIKAT MË MË TË MIRA NGA PËRDORIMI I MJETEVE DIGJITALE SI MËNYRË PËR TË ULUR KORRUPSIONIN NË REPUBLIKËNEMAQEDONISËSË VERIUT.....	24
2. PRAKTIKAT MË MË TË MIRA NGA PËRDORIMI I MJETEVE DIGJITALE SI MËNYRË PËR TË ULUR KORRUPSIONIN NË EVROPË.....	26
3. KONKLuzioni.....	28
BIBLIOGRAFIA	29

KAPITULLI I

HYRJE

Në kuadër të këtij raporti janë paraqitur rezultatet nga analiza e gjendjes me dixhitalizimin dhe disponueshmërinë e e-shërbimeve në disa institucione publike nga sektorë të ndryshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Analiza zbatohet si pjesë e projektit "Nxitja e inovacionit digjital institucional - një mjet për të luftuar korrupsionin!", realizuar nga Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI) dhe Qendra për Inovacionin Social Blink 42-21, me mbështetje financiare të Sekretariatit të përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi i analizës është të identifikojë sfidat nga aspekti organizativ dhe funksional në institucionet publike me mandat për të vepruar në më shumë sfera, të cilat potencialisht mund të rëndojnë ose pengojnë zbatimin e kompetencave dhe detyrave aktuale të institucioneve, por edhe të propozojë masa konkrete për përmirësimin e përmbushjes së qëllimeve dhe detyrave të institucionit, që synojnë arritjen e rezultateve të pritshme, me theks të veçantë në dixhitalizimin dhe aksesin e qytetarëve në shërbimet e tilla.

Analiza funksionale synon t'i përgjigjet situatës aktuale me dixhitalizimin e sektorëve të synuar:

- jurisprudenca;
- policia;
- vetëqeverisja lokale;
- shëndeti publik;
- arsimi; dhe
- ekonomia.

Në këtë kontekst, institucionet që operojnë në kuadër të këtyre sektorëve analizohen nga disa aspekte: Shërbimet elektronike (e-shërbimet), si hapje dhe komunikim me qytetarët dhe sektorin e biznesit (lloji dhe disponueshmëria e shërbimeve, mënyrat dhe lloji i komunikimit përmes zgjidhjeve të TI-së).

METODOLOGJIA

Analiza u realizua duke zbatuar metodat e hulumtimit në desk, para së gjithash, grumbullimin dhe analizën e të dhënave sekondare dhe terciare. Për nevojat e analizës është bërë një pasqyrë e kornizës ligjore në fushat e dixhitalizimit dhe shërbimeve elektronike, strategjive dhe planeve të veprimit në fushën e dixhitalizimit, si dhe analiza e të dhënave të disponueshme për infrastrukturën e TI-së, kujdesin për kompetencat e TI-së midis punonjësve, llojet e shërbimeve elektronike . Janë konsultuar edhe analizat dhe rezultatet e hulumtimit mbi këtë temë të realizuara viteve të fundit dhe është bërë monitorimi dixhital i prezencës, aksesit dhe llojit të zgjidhjeve dixhitale të cilat i përdorin institucionet publike për komunikim dhe për të ofruar shërbime të përshtatshme për qytetarët dhe sektorin e biznesit.

Raporti është i ndarë në disa pjesë. Pjesa e parë i prezanton konceptet bazë të dixhitalizimit, e-shërbimet dhe rëndësinë e tyre për përmirësimin e punës së administratës publike, transparencën e institucioneve dhe zhvillimin e demokracisë. Pjesa e dytë i prezanton informacionet për zhvillimin e dixhitalizimit dhe e-shërbimeve në mesin e institucioneve publike, ku jepet një pasqyrë e ngjarjeve kryesore, dispozitave ligjore dhe prioriteteve strategjike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në këtë sferë. Pjesa e tretë jep pasqyrën e shërbimeve elektronike të disponueshme dhe formave të përdorimit të TIK-ut në fushat e jurisprudencës, policisë, vetëqeverisjes lokale, shëndetit publik, arsimin dhe ekonomisë. Pjesa e katërt paraqet pikëpamjet përmbyllëse.

1. DIXHITALIZIMI I E-SHËRBIMEVE – KONCEPTET BAZË

Funksionimi efikas dhe profesional i administratës publike është një nga faktorët kyç për zhvillimin demokratik dhe ekonomik të një vendi. Në këtë kontekst, reforma e administratës publike është një proces kompleks, i cili përfshin përdorimin komplementar të një sërë politikash, masash dhe instrumentesh. Një aspekt i rëndësishëm në reformën e administratës publike është futja e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) si një mjet për të përmirësuar funksionimin e saj. Në këtë kontekst, përdorimi i TIK-ut është një instrument që mund të forcojë dhe t'u japë efektivitet dhe kredibilitet masave të tjera reformuese.

Megjithëse përdorimi i TIK-ut në punën e administratës publike ka një histori të gjatë (nga mesi i shekullit të kaluar), paraqitja e internetit ka ofruar bazën për vendosjen e komunikimit të gjerë dhe rritjen e disponueshmërisë së të dhënave dhe shërbimeve përmes faqeve të internetit të institucioneve shtetërore, si dhe për hapjen e një kanali komunikimi elektronik, përmes të cilit qytetarët mund të kenë akses në të dhënat dhe shërbimet e institucioneve shtetërore në çdo kohë dhe nga çdo vend.¹

Aplikimi i TIK-ut me qëllim të rritjes së cilësisë së punës së administratës publike në praktikë, njihet si procesi i zhvillimit të qeverisë elektronike (e-qeveri). Zhvillimi i modeleve të e-qeverisë mund të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të ndryshme shoqërore, të cilat përgjithësisht mund të grupohen në katër grupe:²

- Ndërtimi i një administrate publike transparente, të ndershme dhe të drejtë;
- Rritja e efektivitetit, efikasitetit dhe produktivitetit të funksionimit të institucioneve shtetërore;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga sektori publik për qytetarët dhe

1 Tosheva, G. dhe Ugrinoski, A., Bazat dhe zhvillimi i E-qeverisë, 2010, Shkup, USAID – projekt për E-qeverinë.

2 Tosheva dhe Ugrinoski, Bezat dhe zhvillimi i E-qeverisë, fq. 11.

komunitetin e biznesit;

- Krijimi i një lloji të ri marrëdhëniesh ndërmjet shtetit nga njëra anë dhe qytetarëve dhe kompanive nga ana tjetër, ku qytetarët dhe sektori i biznesit janë në fokus të procesit të vendimmarrjes dhe marrin pjesë aktive në definimin e masave dhe politikave konkrete“.

Është e rëndësishme të theksohet se qëllimi i teknologjisë në këtë rast është që ajo të jetë një mjet ose lehtësues i procesit, por jo një zgjidhje magjike për të gjitha problemet me administratën e ngurtë, të mbyllur, joefikase dhe të shtrenjtë.

Përkufizimet e ndryshme të e-qeverisë shpesh ndryshojnë për sa i përket gjerësisë dhe përcaktimit të rolit të e-qeverisë në reformën e administratës publike. Janë propozuar dy përkufizimet e mëposhtme:³

“Shfrytëzimi i TIK-ut nga ana e shtetit me qëllim të rritjes së volumit dhe cilësisë së informacioneve dhe shërbimeve që shteti ua siguron qytetarëve, bizneseve, OJQ-ve dhe organeve tjera shtetërore, të ofruara në mënyrë efikase, ekonomike dhe të qasshme, duke garantuar një funksionim të përgjegjshëm, llogaridhënës dhe transparent dhe forcimi i proceseve demokratike “.⁴

“Implementimi i TIK-ut në administratën publike, i kombinuar me ndryshime organizative dhe shkathtësi të reja, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike dhe proceseve demokratike dhe forcimin e mbështetjes së politikave publike“.⁵

Ndarja kryesore e projekteve për e-qeveri është në e-shërbime dhe e-pjesëmarrje.⁶ E-shërbimet paraqesin të gjitha aplikacionet që u mundësojnë përdoruesve (personave fizikë dhe personave juridikë) të ushtrojnë të drejta, detyrime dhe interesa të caktuara.

E-pjesëmarrja paraqet një kategori më të gjerë se kategoria e e-shërbimeve dhe ndryshon nga e-shërbimet siç luan në forcimin e proceseve demokratike në shoqëri. E-pjesëmarrja përfshin mjetet për konsultim me qytetarët, por edhe mjete që u mundësojnë atyre të ndjekin punën e përfaqësuesve të tyre të zgjedhur.

Në përgjithësi, iniciativat për zhvillimin e e-qeverisë mund të ndahen në tre grupe:

- Iniciativat G2G - shërbimet dhe format e komunikimit ndërmjet organeve shtetërore.
- Iniciativat G2B - produkte dhe shërbime për të lehtësuar punën e sektorit të biznesit.
- Iniciativat G2C - produkte dhe shërbime për të lehtësuar aksesin për qytetarët.

Bashkimi Evropian e mat përsosshmërinë e shërbimeve elektronike si një tregues kyç i progresit të anëtarëve të tij në fushën e zhvillimit të qeverisjes elektronike. Metodologjia e BE-së përfshin monitorimin e nivelit të pajtueshmërisë në ofrimin e një numri të caktuar të e-shërbimeve. Metodologjia të cilën e aplikon BE-ja parashikon pesë shkallë të sofistikimit:

1. Informim,
2. Ndërveprim njëkahësh,
3. Ndërveprim dykahësh,
4. Transaksion,
5. Personalizim


3 Tosheva dhe Ugrinoski, Bazat dhe zhvillimi i E-qeverisë, fq. 13.

4 E-Government Toolkit, InfoDev, 2008.

5 We - Go: Enhancing Western Balkan e-Government Expertise, 2008.

6 Tosheva dhe Ugrinoski, Bazat dhe zhvillimi i E-qeverisë.

Figura 1. Përsosshmëria e e-shërbimeve.



1.1. INFORMIMI

Informimi si një fazë në procesin e krijimit të e-qeverisë presupozon një proces përmes të cilit shteti vë në dispozicion të gjithë informacionin përkatës për inspektim dhe përdorim nga institucionet e tjera shtetërore dhe të gjitha kategoritë e shoqërisë.⁷

Ky është një nivel elementar i e-shërbimeve, që prapëseprapë ka një rëndësi të madhe, veçanërisht për nivelin e informimit të publikut, gjë që kontribuon në komunikimin më të lehtë me shtetin. Meqë kemi të bëjmë me një fazë të thjeshtë, informimi është zakonisht faza fillestare e prezantimit të shërbimeve elektronike.

Përveç futjes së informacioneve, është e rëndësishme që atë të prezantohen në një mënyrë që mundëson përdorimin e tyre të lehtë dhe navigacionin. Për këtë qëllim, shpesh këto e-shërbime janë të organizuara në ueb portale që mundësojnë qasje të lehtë në shumë lloje të shërbimeve për qytetarët.

Gjithashtu, është po aq e rëndësishme që këto shërbime të prezantohen në mënyrë cilësore dhe koncize. Përkatësisht, për shumë qytetarë, informacioni është forma e parë e e-shërbimeve me të cilën ballafaqohen, kështu që këto përvoja të para mund të kenë një ndikim të madh në qëndrimet e tyre dhe përdorimin e shërbimeve elektronike në të ardhmen.

⁷ Tosheva dhe Ugrinoski, Bazat dhe zhvillimi i E-qeverisë, fq. 17.

1.2. NDËRVEPRIM NJËKAHËSH

Ndërveprimi është një formë e-shërbimeve që mundëson komunikimin ndërmjet institucioneve shtetërore, nga njëra anë, dhe qytetarëve dhe bizneseve, nga ana tjetër. Ky lloj ndërveprimi nënkupton dhënien e informacionit vetëm në një drejtim, nga organi shtetëror te përdoruesi, ose anasjelltas. Ajo që e dallon ndërveprimin njëkahësh nga ndërveprimi i dyanshëm është paaftësia për t'u përgjigjur nga ana tjetër.

1.3. NDËRVEPRIM DYKAHËSH

Ndërveprimi i dyanshëm është një formë më të sofistikuar të komunikimit që mund të realizohet në mënyra të ndryshme:

- Kontakt përmes postës elektronike ose forma të qasshme në ueb faqet e institucioneve,
- Ueb forma për dërgimin e të dhënave, komentimin ose kërkimin e informacionit.
- Ueb formularë për pyetje dhe përgjigje të administruara nga institucionet shtetërore, përmes të cilave përdoruesit mund të komunikojnë me përfaqësues të institucioneve përkatëse. Kjo formë mundëson ndërveprim të drejtpërdrejtë dhe ndërveprim të vonuar në kohë, si dhe ndërveprim simultan kur përfshihen më shumë njerëz.⁸

1.4. TRANSAKSIONI

Transaksioni ka të bëjë me mundësinë e ekzekutimit të plotë të proceseve të caktuara në mënyrë elektronike. Në fakt, transaksioni nënkupton që e-shërbimi të përfshijë shkëmbimin e informacionit ndërmjet një institucioni të caktuar dhe përdoruesve të shërbimeve të tij, gjë që çon në zbatimin e një procedure të caktuar elektronike. Kjo mund të përfshijë pagesa, si për shembull tatime ose taksa administrative.

Kjo paraqet formën më të sofistikuar të ndërveprimit dhe është gjithashtu më e ndërlikuar për t'u zbatuar.

1.5. PERSONALIZIMI

Niveli i pestë i personalizimit të shërbimeve elektronike u aprovua në vitin 2007. Personalizimi ofron informacion mbi ekzistencën e një "procedure elektronike plotësisht të integruar që mundëson thjeshtimin e procedurave administrative dhe rritjen e konsistencës së të dhënave pa aktivitete shtesë nga përdoruesit".⁹

Në këtë kontekst, personalizimi bazohet në dy koncepte:

1. Qëndrimi proaktiv i sektorit publik në drejtim të ofrimit të shërbimeve, me theks në aktivitetet e vetë-iniciuara për të ngritur cilësinë e shërbimeve,

⁸ Tosheva dhe Ugrinoski, Bazat dhe zhvillimi i E-qeverisë.

⁹ Tosheva dhe Ugrinoski, Bazat dhe zhvillimi i E-qeverisë, fq. 21.

- Ofrimi automatik i shërbimeve, sipas të cilit sektori publik automatikisht mundëson që shërbimet për realizimin e të drejtave të caktuara sociale dhe ekonomike të përfitohen automatikisht, pa parashtruar kërkesë formale.

1.6. PËRPARËSITË E APROVIMIT TË E-SHËRBIMEVE

Duhet theksuar se zbatimi i qeverisjes elektronike nuk duhet të implementohet si një nismë e izoluar, por duhet të jetë pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për reformën e administratës publike, si pjesë integrale e zhvillimit shoqëror, politik dhe ekonomik. E-qeveria në thelb paraqet një mjet komplementar për zbatimin e proceseve gjithëpërfshirëse reformatore në shoqëri.

Zbatimi i qeverisjes elektronike ka përfitimet e veta:¹⁰

- Efikasitetit të rritur në dhënien e shërbimeve:
 - qasje më e lehtë në shërbimet publike;
 - procedura të thjeshtuara;
 - zvogëlimin e numrit të hapave për marrjen e një shërbimi të caktuar;
 - zvogëlimin e numrit të dokumenteve për verifikimin e të dhënave të caktuara;
 - lehtësim i mënyrës së parashtrimit të dokumenteve të nevojshme.
 - kursimin e kohës;
 - shpenzime të zvogëluara:
 - shpenzime për vizita në institucionet shtetërore;
 - reduktim real i angazhimit të sektorit publik, gjë që kontribuon në efikasitetin dhe efektivitetin e tij;
 - zgjidhje inovative për menaxhimin racional dhe disponimin me mjetet publike të buxhetit.
- Transparencë e rritur dhe fuqizim i proceseve demokratike:
 - informim transparent;
 - kufizim dhe eliminim i diskrecionit;
 - regjistrim i veprimeve në procedura, me çka rritet transparenca dhe kontrolli në punën e administratës;
 - shpërndarje transparente dhe të drejta;
 - përmirësim i kushteve dhe mjedisit ku qytetarët i realizojnë të drejtat e tyre;
 - kontakt dhe komunikim më i lehtë me përfaqësuesit e zgjedhur në mënyrë demokratike.
- Përfitime më të gjera ekonomike dhe sociale:
 - përmirësim i konkurrencës së subjekteve afariste;
 - ndikim pozitiv në zhvillimin e shoqërisë së informacionit;
 - zhvillim i industrisë së teknologjisë informatike.

1.7. SFIDAT PËR APROVIMIN E E-SHËRBIMEVE

Një gabim i zakonshëm që bëhet gjatë implementimit të shërbimeve elektronike është shndërrimi mekanik i procedurave të letrës në ato elektronike. Një qasje e tillë ndaj zhvillimit të e-shërbimeve nuk mundëson një transformim thelbësor të funksionimit të administratës publike dhe sjelljes së saj ndaj përdoruesve.

¹⁰ Tosheva dhe Ugrinoski, Bazat dhe zhvillimi i E-qeverisë.

Është e rëndësishme me këtë rast të theksohet se suksesi i zbatimit të e-qeverisë varet nga disa faktorë:¹¹

- mbështetje e fuqishme politike e nevojshme për zbatimin e procesit,
- Potencial i përkushtuar dhe profesional njerëzor me njohuritë e nevojshme për problematikën dhe njohje e suksesshme e metodologjisë së menaxhimit me projekte dhe resurse adekuate financiare.

Ekzistojnë disa sfida për zbatimin e e-shërbimeve. Në fakt, bëhet fjalë për një proces kompleks, suksesi i të cilit varet nga disa faktorë. Bashkëngjitur janë cekur disa aspekte që mund të kenë ndikim në rrjedhën dhe suksesin e procesit të dixhitalizimit dhe të e- shërbimeve.

1.7.1. HENDEKU DIXHITAL

Hendeku dixhital paraqet një koncept që trajton mundësitë e ndryshme për aksesin dhe përdorimin e TIK-ut. Hendeku dixhital mund të shqyrtohet në nivele të ndryshme, nga një kontekst global në një kontekst mikro. Në parim, për hendekun dixhital të rëndësishme janë aspektet e mëposhtme:

- përqindja e popullsisë që ka akses në teknologji;
- përqindja e popullsisë që ka akses në internet;
- dituri për t'i shfrytëzuar këto teknologji.

1.7.2. BUOKRACIA DHE MENTALITETI I PËRDORUESVE

Edhe një sfidë tjetër lidhet me qëndrimin e përgjithshëm të përdoruesve ndaj sistemit të administratës publike dhe gatishmërinë për t'iu përshtatur ndryshimeve. Në këtë kontekst, në mënyrë të pashmangshme lind çështja e besimit në efikasitetin e funksionimit të administratës. Arsyeja e dytë lidhet me rezistencën ndaj zotërimit të procedurave dhe teknikave të reja. Sfida e tretë lidhet me vetë administratën, respektivisht faktin që dixhitalizimi i shërbimeve e bën të pamundur vendimmarrjen subjektive, ndaj edhe vetë administrata mund të shfaqë rezistencë ndaj këtyre zgjidhjeve.

¹¹ Tosheva dhe Ugrinoski, Bazat dhe zhvillimi i E-qeverisë, fq. 20.

2. DIXHITALIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Lista e zgjidhjeve ligjore dhe nënligjore që përbëjnë kornizën ligjore për zbatimin dhe funksionimin e zgjidhjeve të e-qeverisë në Maqedoninë e Veriut përfshin ligjet si në vijim:

- Ligji për të dhënat elektronike dhe nënshkrimin elektronik, i cili rregullon funksionimin dhe punën elektronik dhe shfrytëzimin e TIK-ut në qarkullimin ligjor dhe pagesor.
- Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, të cilat ndryshime mundësojnë dorëzimin elektronik të parashtresave dhe nënshkrimin elektronik si mënyrë valide për autentifikim e parashtresave elektronike..
- Ligji për taksat administrative, i cili rregullon pagesën e taksave administrative në mënyrë elektronike.
- Ligji për administrim elektronik, i cili së bashku me aktet nënligjore përkatëse zbaton parimet dhe standardet për realizimin e shkëmbimit të të dhënave dhe dokumenteve në formë elektronike ndërmjet të gjitha organeve shtetërore.
- Ligji për qasje të lirë në informata me karakter publik, i cili përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurën përmes të cilave personat fizikë dhe juridikë mund të realizojnë të drejtat për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik nga institucionet shtetërore.
- Rregullore për masat teknike dhe organizative për sigurimin e diskrecionit dhe mbrojtjes së përpunimit të të dhënave personale, me çka përcaktohen llojet e masave dhe nivelet e ndryshme të aplikimit të tyre për mbrojtjen e kategorive të ndryshme të të dhënave gjatë shfrytëzimit të tyre në mjedisin elektronik dhe përpunimit automatik.
- Ligji për regjistrin qendror të popullsisë, me të cilin vendoset unifikim në menaxhimin me bazat e të dhënave të institucioneve publike.
- Ligji për administrim elektronik dhe për shërbimet elektronike, i cili i referohet ofrimit efektiv dhe efikas të shërbimeve elektronike.
- Ligji për dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe shërbime konfidenciale i përcakton kushtet për dixhitalizimin e shërbimeve.
- Ligji për futjen e një sistemi të menaxhimit të cilësisë dhe një kornize të përbashkët për vlerësimin e punës dhe ofrimit të shërbimeve në shërbimet shtetërore.
- Ligji për komunikimet elektronike.
- Ligji për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik.

Procesi i zhvillimit të dixhitalizimit dhe aprovimit të e-shërbimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2009 u zhvillua pa një strategji të qartë. Megjithatë, në periudhën paraprake, nga viti 2005 deri në vitin 2009, janë realizuar disa projekte të cilat hodhën themelet për zhvillimin e mëtutjeshëm të e-qeverisë.

Në vitin 2008 është themeluar Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA). MSHIA është organi më i lartë i administratës shtetërore i ngarkuar me zbatimin e strategjisë për e-qeveri dhe zhvillimin e shoqërisë informatike.

Në periudhën 2010-2012 është miratuar dhe zbatuar strategjia e parë kombëtare për e-qeveri.

Në vitin 2015 u miratua një Strategji afatshkurtër e TIK-ut për periudhën 2015-2017, si hap i parë drejt miratimit të një strategjie kombëtare afatgjate.

Në shkurt të vitit 2018 u miratua Strategjia për reforma në administratën publike 2018-2022 me një plan veprimi, ku theksi vihet në problemin e dixhitalizimit, veçanërisht në aspektin e prokurimit

publik dhe ndërveprueshmërisë. Si pjesë e rritjes së cilësisë dhe aksesit në shërbimet publike, vëmendje përkatëse i kushtohet ngritjes së kapaciteteve të administratës publike për zbatimin e dixhitalizimit.

Në vitin 2020, RMV miratoi një draft strategji dhe plan veprimi për Strategjinë Kombëtare për TIK 2021-2025. Në kuadër të tekstit të strategjisë, janë paraqitur edhe informacione për gjendjen e dixhitalizimit dhe progresin në aprovimin e shërbimeve elektronike në punën e institucioneve publike.

Nga dokumenti mund të konstatohet se nuk ekziston një sistem i centralizuar i TIK-ut të Qeverisë dhe institucioneve publike, gjegjësisht se ministritë, institucionet, agjencitë, institucionet arsimore, institucionet shëndetësore kanë infrastrukturën e tyre të TIK-ut. Në dokument thuhet se ka nisur një projekt ndërveprueshmërie, ku sfida kryesore mbetet mungesa e standardizimit për infrastrukturën (klimatizimi, furnizimi i pandërprerë me energji elektrike, gjeneratorë si mbështetje etj.) softuerëve dhe harduerëve.¹² Për më tepër, “nuk ekzistojnë politika dhe udhëzime për siguri dhe cilësi minimale të shërbimit . Qeveria e RMV-së nuk ka lidhur marrëveshje të përgjithshme kornizë me ofruesit e shërbimeve të mbështetjes dhe mirëmbajtjes së TIK-ut, as marrëveshje për përdorimin e sasive më të mëdha të softuerit. Shumë shpesh, infrastruktura, hardueri, softueri dhe sistemet operative janë të vjetruara, njëloj siç është dokumentacioni i tyre, ndërsa nuk ekzistojnë gjithmonë marrëveshje për mirëmbajtje dhe mbështetje”.¹³

Në dokument konstatohet se nuk ekziston punë sistematike për menaxhimin e sistemeve të TIK-ut të institucioneve publike, për sa i përket funksionimit dhe mirëmbajtjes së pjesëve rezerve, blerjes së pjesëve për zëvendësimin, licencave të softuerit, mbindërtime, materiale harxhuese, trajnime të rregullta të stafit të TIK-ut, etj. Thuhet se në institucione të caktuara nuk respektohen standardet bazë të sigurisë, me ç'rast janë detektuar rrezikshmëri nga përmbytjet dhe zjarret. Menaxhimi jo i duhur i këtyre sistemeve rezulton në mbinxehje të serverëve, kolaps të sistemeve në muajt e verës dhe të ngjashme.

Një problem relevant që ceket në draft-strategjinë është mungesa e stafit adekuat në institucionet publike për mbështetjen dhe zhvillimin e dixhitalizimit. Gjegjësisht, ka mungesë të profesionistëve të TIK-ut, siç janë inxhinierët sistemor, administratorët sistemor, programuesit, menaxherët e projekteve, profesionistët e mbështetjes teknike dhe stafi adekuat për pozita të tjera relevante. Kjo mungesë e stafit profesional pritet të thellohet në periudhën e ardhshme me ndërrimin e brezave, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë gjetjen e zëvendësimit për profesionistët që dalin në pension.

Institucionet publike nuk janë konkurruese, për shkak të pagave jokonkurruese në sektorin publik, gjë që e ndërlikon procesin e rekrutimit të stafit të ri dhe mbajtjen e stafit ekzistues. Përveç kësaj, institucionet publike ofrojnë pak ose aspak mundësi për avancim në karrierë dhe zhvillim profesional. Kjo nuk është një situatë që prek vetëm sektorin publik, por ka një ndikim të madh në dinamikën dhe efektivitetin e zbatimit të procesit të dixhitalizimit dhe aprovimit të shërbimeve elektronike në punën e institucioneve publike.

Mungesa e resurseve njerëzore me ekspertizë adekuate vë në pikëpyetje procesin e dixhitalizimit efektiv dhe pritet që në të ardhmen funksionimi i suksesshëm i institucioneve publike të bëhet gjithnjë e më i varur nga ky faktor. Gjegjësisht, me përparimin e dixhitalizimit dhe aprovimin e mundësive më të mëdha për ofrimin e e-shërbimeve, menaxhimin e të dhënave dhe komunikimin, kërkesa për staf adekuat do të rritet. Gjithashtu, kjo krizë ka ndikim në sigurinë dhe privatësinë e të dhënave, përkatësisht besimin në institucionet publike.¹⁴

Në rrjedhë është hartimi i Strategjinë nacionale për dixhitalizimin e sistemit arsimor, të cilën e ka

12 Strategjia Kombëtare e TIK-ut të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021 – 2025 versioni 1.1, 2020.

13 Strategjia Kombëtare e TIK-ut të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021 – 2025 versioni 1.1, 2020.

14 Strategjia Kombëtare e TIK-ut të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021 – 2025 versioni 1.1, 2020.

paralajmëruar ministrja Milla Carovska.¹⁵ Si pjesë e përpjekjeve për dixhitalizim, përmendet sërish krijimi i një platforme të vetme kombëtare të mësimin në distancë, zhvillimi i së cilës filloi në fillim të pandemisë Covid-19.

Në një tribunë pak kohë më parë, ministri aktual i shoqërisë informatike dhe administratës, Jeton Shaqiri, i ceku prioritetet e mëposhtme:¹⁶

- Ngritja e një institucioni qendror për koordinimin dhe zbatimin e procesit të dixhitalizimit të shoqërisë dhe mbështetje të plotë të TI-së për institucionet shtetërore,
- Deri në fund të vitit 2021, të paktën 30% e organeve të administratës shtetërore duhet të kenë aprovuar sistem elektronik për automatizimin e procedurave administrative, me afat për aprovimi në të gjitha organet e administratës shtetërore deri në fund të vitit 2021,
- Vazhdimi i hapjes së qendrave “Një pikë për të gjitha shërbimet” në çdo qytet të vendit.
- Nevojitet finalizimi i strategjisë kombëtare të TIK-ut dhe nënkuptohet implementimi i saj.

Në kuadër të hulumtimit të realizuar nga Kitanov dhe bashkëpunëtorët,¹⁷ konstatohet se prezantimi i e-Qeverisë mbetet sfidë e rëndësishme për institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal. Autorët e hulumtimit theksojnë se sfidat kryesore për procesin e dixhitalizimit janë të lidhura me hendekun digjital në mesin e qytetarëve të Maqedonisë së Veriut dhe autoritetet duhet të fokusohen në rritjen e vazhdueshme të literacisë dixhitale te popullata.

Në kuadër të hulumtimit të kryer nga Kitanov dhe bashkëpunëtorët, janë mbledhur të dhëna nga 10 vetëqeverisje lokale dhe 3 ministri. Sipas rezultateve krahasimore të BE-së për Maqedoninë e Veriut për sa i përket disa indikatorëve: administrimi i fokusuar i përdoruesit, qeverisja transparente, mobiliteti i biznesit, mundësuesit kryesorë, Maqedonia e Veriut tregon rezultate të dobëta për sa i përket të gjithë indikatorëve të inspektuar. Një nga pikat më të dobëta ka të bëjë me certifikatat dixhitale (nënshkrime, autentifikim) të cilat janë ende në fazat fillestare të implementimit.

Për sa i përket disponueshmërisë dhe llojit të zhvillimit të shërbimeve elektronike, Maqedonia e Veriut renditet nën mesataren e vendeve anëtare të Unionit. Gjegjësisht, nuk ka automatizim të plotë të të gjitha shërbimeve, dhe shumica e shërbimeve ofrohen në nivel informacioni ose komunikimi njëkahësh.¹⁸

Progres të dukshëm në përmirësimin e punës së institucioneve publike, përmes digxhitalizimit dhe rritjes së volumit dhe cilësisë së shërbimeve elektronike në dispozicion, ka Portali Kombëtar për e-shërbime në dhjetor 2019 (www.uslugi.gov.mk). Përmes këtij portali, qytetarët dhe personat juridikë mund të kenë akses në një sërë shërbimesh nga institucionet publike në fusha të ndryshme. Shërbimet plotësuese mund të ofrohen përmes portaleve të e-shërbimeve nën ministri të ndryshme, si në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe të ngjashme.

E rëndësishme për përsheptimin dhe rritjen e efektivitetit të procesit të dixhitalizimit dhe kapacitetit për ndërveprim është aprovimi i një regjistri qendror të popullsisë. Me këtë regjistër institucionet mund të shkëmbejnë të dhëna për qytetarët për efektivitet dhe efikasitet më të madh në ofrimin e shërbimeve.

15 Po hartohet Strategjia kombëtare për dixhitalizimin e sistemit arsimor, 360 Gradë, 10 shtator 2020, huazuar nga: <https://360stepeni.mk/se-podgotvuva-natsionalna-strategjija-za-digitalizatsija-na-obrazovniot-sistem/>.

16 Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, ministri i shoqërisë Informatike dhe administratës Jeton Shaqiri mori pjesë në eventin online “Dialogët për Axfordën Dixhitale”, 30 tetor 2020, huazuar nga: <https://www.mioa.gov.mk/?q=mk/node/3159>.

17 Kitanov B., Ibraimi G., Gusev M., Scanning of services based on E-Governance Macedonia 2020.

18 Kitanov B., Ibraimi G., Gusev M., Scanning of services based on E-Governance Macedonia 2020.

3. PASQYRË E E-SHËRBIMEVE TË DISPONUESHME NË SEKTORË TË VEÇANTË

3.1. JURISPRUDENCA

Një pjesë e konsiderueshme e e-shërbimeve të disponueshme në fushën e jurisprudencës janë në dispozicion në portalin kombëtar të e-shërbimeve www.uslugi.gov.mk. Që të mundën t'i shfrytëzojnë shërbimet e portalit, qytetarët duhet të kenë të dhëna eID me nivele të ndryshme sigurie. Për e-shërbimet bazë, zakonisht kërkohet një eID me siguri të ulët, e cila merret me regjistrim dhe verifikim nga një institucion kompetent.

Në portalin e e-shërbimeve në pjesën Jurisprudenca dhe të drejtat e njeriut, të disponueshme janë nënkategoritë e mëposhtme:

- Kundërvajtjet dhe dënimet
- Sistemi juridik
- Ndihma juridike
- Barazia gjinore
- Mbrojtja nga diskriminimi
- Bashkësitë fetare
- Mbrojtja e të dhënave personale

Në nënkategoritë Kundërvajtje dhe dënime, Barazi gjinore, Bashkësitë fetare dhe Mbrojtja nga diskriminimi nuk janë të disponueshme e –shërbimet.

Në kuadër të nënkategorisë Sistemi juridik të disponueshme janë shërbimet në vijim:

- Marrja e provimit profesional për një ekspert
- Këqyrja në listën e logove për akses të zbatuar në të dhënat personale të përdoruesit
- Marrja e provimit të jurisprudencës
- Provim plotësues i jurisprudencës
- Lëshimi i vërtetimit nga evidenca penale për persona fizikë
- Regjistrimi i avokatit në regjistrin e avokatëve për ndihmë juridike sekondare
- Marrja e licencës për pajtues, përkatësisht arbitër, për kontestet e punës
- Miratimi për përdorimin e fjalës “Maqedoni” dhe fjalëve që rrjedhin prej saj si dhe shkurtesave të saj në emër të organizatës
- Regjistrimi i shoqatës në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë
- Regjistrimi i fondacionit në regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë
- Regjistrimi në regjistrin e formave organizative të organizatave të huaja
- Krijimi i një institucioni privat që ushtron veprimtari në fushën e kulturës për qëllime jofitimprurëse
- Emërimi noterit
- Emërimi i zëvendës noterit
- Emërimi i ndihmës noterit
- Marrja e provimit noterial
- Emërimi i përmbaruesit
- Emërimi i ndihmës përmbaruesit
- Shënimi i ndryshimit të të dhënave në regjistrin e fondacioneve
- Licencë për kryerjen e vlerësimit në sferat nën Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave
- Aktvendim për vërtetimin e interesit publik të një donacioni/sponsorizimi të caktuar
- Marrja e provimit për përmbarues

Në kuadër të kësaj nënkategorie, vetëm dy shërbime janë të disponueshme në nivel të transaksionit, ndërsa shërbimet e tjera janë të disponueshme vetëm në nivel të informacionit.

Në kuadër të nënkategorisë Ndhimë Juridike të disponueshme janë shërbimet e mëposhtme:

- Ndhimë e primare juridike
- Ndhimë sekondare juridike
- Regjistrimi në regjistrin e shoqatave të shoqërisë civile të autorizuar për dhënien e ndihmës primare juridike
- Regjistrimi në regjistrin e avokatit në regjistrin e avokatëve për ndihmë sekondare juridike
- Regjistrimi në regjistrin e fakulteteve juridike të autorizuar për ofrimin e ndihmës primare juridike

Në kuadër të nënkategorisë Mbrojtja e të dhënave personale, të disponueshme janë shërbimet e mëposhtme:

- Vërtetim për të dhënat personale të përfshira në regjistrin qendror të popullsisë
- Këqyrje në listën e logove për akses deri te të dhënat personale të përdoruesit.

Të dy shërbimet janë të disponueshme në nivel transaksioni me eID të nivelit të ulët.¹⁹

E-shërbimet plotësues janë në dispozicion në Portalin gjyqësor të Maqedonisë së Veriut (<http://www.sud.mk/>) dhe në ueb faqet e gjykatave. Në fakt, faqet e internetit të gjykatave themelore i përditësojnë rregullisht informacionet për vendimet gjyqësore. Ueb-faqet mund të përdoren për të komunikuar në dy mënyra, për të paraqitur ankesa, si dhe për të përdorur sistemin për dorëzim dhe pranim elektronik të akteve (<https://edostava.sud.mk/>).

3.2. POLICIA

Në portalin E-shërbime, në domenin e kompetencave të policisë (Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut) janë të disponueshme E-shërbimet e mëposhtme në kategori të ndryshme:

Në pjesën Dokumente personale të disponueshme janë nënkategoritë e mëposhtme:

- Letërnjoftimi
- Dokumente udhëtimi
- Leje të vozitjes
- Leje tjera
- Nënshetësi
- Paraqitje e dokumenteve jo të vlefshme
- Akte të tjera reale

Në kuadër të nënkategorisë Letërnjoftimi, të disponueshme janë shërbimet e mëposhtme:

- Ndryshimi i emrit personal
- Përcaktimi i numrit amë të qytetarit kur numri amë nuk është përcaktuar

¹⁹ Shërbimet janë të disponueshme për qytetarët që posedojnë nivele të ndryshme sigurie në një certifikatë sigurie. Niveli i ulët i eID do të thotë se për të marrë shërbimin e duhur, qytetarët përdorin të dhëna për logim që verifikohen nga autoritetet shtetërore (më së shpeshti verifikohen nga Drejtoria e të Ardhurave Publike). Nivelet më të larta të eID nënkuptojnë edhe shfrytëzimin e një certifikate dixhitale për nënshkrimin elektronik, gjë që është e detyrueshme për shërbimet elektronike për personat juridikë.

- Anulimi i numrit amë të qytetarit
- Lëshimi i letërnjoftimit për një person me status refugjati dhe një personi nën mbrojtje subsidiare
- Shpallja e letërnjoftimit si e pavlefshme

Të gjitha shërbimet janë të disponueshme vetëm në nivel informacioni.

Në kuadër të nënkategorisë Pasaporta të disponueshme janë shërbimet e mëposhtme:

- Shpallja e dokumentit të pavlefshëm
- Pasaportë për të huajt
- Leje për kalimin e kufirit jashtë vendkalimeve kufitare dhe jashtë orarit të caktuar të punës në vendkalimet kufitare

Nga shërbimet e disponueshme, vetëm një shërbim është i disponueshëm në nivelin e transaksionit, ndërsa shërbimet e tjera janë të disponueshme vetëm në nivelin e informacionit.

Në kuadër të nënkategorisë Lejet tjera, të disponueshme janë 170 shërbime që kanë të bëjnë me lejet për përdorim të armëve, leje për lëvizje gjatë periudhave të ndalimit të lëvizjes, transportit të armëve dhe municionit, regjistrimit në regjistrin e kontabilistëve dhe të ngjashme. Dhjetë nga këto shërbime janë të disponueshme në nivel transaksioni, ndërsa pjesa tjetër në nivel informacioni.

Në kuadër të nënkategorisë Shtetësia janë të disponueshme 15 shërbime:

- Marrja e shtetësisë sipas origjinës (për fëmijët e lindur jashtë vendit ku njëri prind është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut)
- Marrja e shtetësisë me lindje në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- Ndërprerja e shtetësisë me lirim
- Marrja e shtetësisë nga origjina (nëse prindërit janë shtetas të RMV)
- Marrja e shtetësisë nga origjina (fëmija i lindur në RMV dhe njëri prind është shtetas i RMV)
- Marrja e shtetësisë me natyralizim
- Marrja e shtetësisë për një të huaj që është i martuar me një shtetas të RMV për të paktën 3 vjet dhe 1 vit qëndrim në RMV
- Marrja e shtetësisë së të huajt i cili është i martuar me shtetas të Republikës së Maqedonisë së paku 8 vjet dhe jeton jashtë vendit
